

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "IDEAL CAMINETTI"

Në Durrës, sot në datën 15/ Janar/ 2021,

- 1) **Z. Gazmir Çela**, atësia, Safet shtetas Shqiptar , lindur në Shijak dhe banues në Durrës, në adresën: L 18, Rruga Vaso Pasha”, i datelindjes 02/08/1977, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me karte identiteti me nr 036731181 dhe nr. personal H70802175M
- 2) **Z. Ramiz Hasani** atësia, Ismet, shtetas kosovar, lindur në Ferizaj dhe banues në Ferizaj, në adresën, Rruga Epopeja e Jezercit Pn , Ferizaj i datelindjes 20/01/1968, gjendja civile i martuar , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Pasaportën nr. P01302464, lëshuar në datën 30/10/2018, nr. personal 1006883083,

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”(i azhornuar ), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” etj.

Z. Gazmir Çela dhe z. Ramiz Hasani themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “**IDEAL CAMINETTI**” sh.p.k.

**Selia** e shoqërisë është në Sallmone, Durrës, në adresën: Sallmone nr pasurie 186/44, volum 8, faqe 206, zona kadastrale 3255 , ndërtesë 1 kat.

**Objekti i shoqërisë është: Prodhim dhe tregtim oxhaqesh. Importin dhe eksportin e lëndëve të para dhe të përpunuara dhe të të gjithë gamës së materialeve që nevojiten për ushtrimin e këtij aktiviteti ashtu si dhe zhvillimi i çdo aktiviteti tjetër të lidhur dhe të nevojshëm për këto proces.**

**Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat.**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.701.400 ( Tre milion e shtateqind e nje mije e katerqind) lekë, i përbërë nga 2 kuota, me nga 50 % pjesëmarrje :**

1. Nje kuotë me vlerë nominale 1.850.700 Lekë dhe zotërohet nga ortaku themelues  
Z. Gazmir Çela
2. Nje kuotë me vlerë nominale 1.850.700 Lekë dhe zotërohet nga ortaku themelues  
Z. Ramiz Hasani

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

### Administrimi i shoqërisë

**Administrator i shoqërisë emërohet z. Gazmir Çela** i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

**Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet.** Administratori emërohet sot në datën 15 Janar 2021 dhe përfundon në datën 15 /Janar/ 2026. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Regjistrimit ( Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” )

**Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.**

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i Përgjithshëm i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaket gëzojnë të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortakët themelues dhe nënshkruhet prej tyre në çdo faqe.

### ORTAKËT THEMELUESË

*Gazmir Çela*

(Gazmir Çela)



(Ramiz Hasani)